



Të drejtat dhe detyrimet

Të punësuarit dhe punëdhënësit kanë të drejta dhe detyrime të ndryshme. Me ligj janë të rregullura p.sh. koha maksimale e punës, e drejta për pushim, dhe sigurimi mbrojtës.

Kontrata e punës

Në rastin normal kontratat e punës bëhen me shkrim. Mirëpo edhe kontratat me gojë janë të vlefshme. Vlejnë vendimet ligjore të drejtës obligative (Obligationenrecht | Droit des obligations). Në të janë standardet kryesore. Prandaj edhe personat pa kontratë pune kanë të drejta të ndryshme, mirëpo dhe detyrime.

Të drejtat e punëmarrësve

Punëmparrësit kanë në Zvicër të drejta ligjore të ndryshme. Nga më të rëndësishmet janë:

- unëdhënësit janë të detyruar, punëtorët e tij t'i lajmëroj te sigurimet sociale, ta bëjë sigurimin për aksident dhe një pjesë të shumës për këto sigurime ta paguaj.
- Të gjithë të punësuarit kanë të drejtë më së paku për katër javë pushim me pagesë. Kjo vlen edhe për personat, që janë me rrogë që paguhet me orë apo ata që punojnë orare jo të plota.
- Koha më e lartë e lejuar për punë është 50 orë në javë. Në disa firma janë vetëm 45 orë dhe në disa të tjera janë orare më të gjata të punës të lejuara.
- Të punësuarit kanë të drejtë për një dëftesë-vlerësuese të punës të tij me shkrim.
- Kush sëmuret apo ka pasur ndonjë aksident dhe që ka punuar më shumë se tre muaj në firmë, ka për një kohë të drejtën e marrjes të rrogës.
- Gratë shtatëzëna dhe gratë, që kanë lindur një fëmijë kanë të drejta të posaçme (mbrojtja për nënë).

Rroga

Në Zvicër nuk ka ligji për rrogë minimale. Mirëpo shumë firma kanë një kontratë pune të përbashkët (GAV | CCT), në të cilat është e përcaktuar rroga minimale. Gratë dhe burrat kanë të drejtën për rroga të njëjta për punë të njëjtë. Në kontratë është e vendosur shuma e rrogës bruto. Paguhet rroga neto, pasi që janë zbritur shumat për sigurime sociale (Sozialabzüge | Déductions sociales). Te personat me leje qëndrimi B, me letërnjoftim F apo N, leje qëndrimi i shkurtër L, leje kalimi i kufirit G, zbriten shumat për sigurime sociale direkt nga rroga nga zyra për tatime burimore (Quellensteuer | Impôt à la source).



Largimi nga puna

Te largimi nga puna, duhet punëdhënësi dhe punëmarrësi tu përmbahen rregullave të vlefshme për kohën në kontratë. Largimi i menjëhershëm nga puna është i mundshëm vetëm në raste përjashtuese. Njeriu mundet çdoherë ta kërkoj me shkrim arsyen e largimit nga puna. Kush është i sëmurë, ka pasur një aksident, është shtatëzënë ose ka lindur një fëmijë, është special i mbrojtur nga largimi prej punës. Nëse punëmarrësi vet largohet nga puna, mundet me ndikue në lartësin e mbështetjes prej sigurimit për të papunët.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-bern.ch/sq/puna/te-drejtat-dhe-detyrimet